



Prishtinë, 20 gusht: 2018  
Kodi i ZRRE: V\_1020\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Nenit 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Nenit 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe Nenit 48 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 paragrafi 1, Nenin 28 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 10, Neni 16 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- Dispozitat e Nenit 4, Neni 5, Neni 8, Neni 10, Neni 17, Neni 19, Neni 21 të Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT);

në seancën e mbajtur më 20 gusht 2018 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. **APROVOHEN** - Kategoritë dhe jetëgjatësia e aseteve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- II. Kategoritë e aseteve dhe jetëgjatësia për asetet e OST/OT është dhënë në tabelën në vijim:

*Tabela 1 – Kategoritë dhe jetëgjatësia e aseteve të OST/OT-së*

Nr.	Kategoritë e Aseteve	Jetëgjatësia (vjet)
I	Ndërtesat, rrugët, rrjetet e kanalizimeve, furnizimi me ujë, puset, ashensorët	50
II	Rrjeti i TL, shtyllat	40
III	Rrjeti i tensionit të ulët, nënstacionet, transformatorët, etj.	30
IV	Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
V	Kontrolli dhe Telekomunikimi, pajisje të ndryshme, mbrojtja nga zjarri	8
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e TI, softuerë, patente, licenca, vetura, etj.	5



III. Kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësia për asetet e OSSH-së është dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 2 - Kategoritë dhe jetëgjatësia e asetëve të OSSH-së

Nr.	Kategoritë e Aseteve	Jetëgjatësia (vjet)
I	Ndërtesat e administratës	50
II	Rrjetet e TM, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	30
III	Rrjetet e TU, nënstacionet, transformatorët e energjisë, dhe pajisjet	25
IV	Stacionet e transformatorit (TMRR dhe TMT) <sup>1</sup> dhe pajisjet	15
V	Njehsorët dhe pajisjet matëse, Kamionet, korpa dhe makineri për punë	10
VI	Mobilet, pajisjet për zyrë	7
VII	Pajisjet e punës, aparatet e pajisjet lexuese, veturat, Kompjuterët , pajisjet TI, softuerë etj.	5

## ARSYETIM

ZRRE në përputhje me përgjegjësitë e dhëna me legjislacionin e cekur në hyrje të këtij Vencimi, e lidhur me përcaktimin e kategorive dhe jetëgjatësisë së asetëve të OST/OT dhe OSSH, ka zhvilluar një proces transparent, ku është përfshirë edhe konsultimi me palët e interesit:

- ZRRE më datë 15 maj 2017 ka iniciuar shqyrtimin e dytë të periudhës rregullative (prill 2018-2022);
- ZRRE me datë 04 korrik 2017 ka nxjerr Raport Konsultativ në lidhje me Jetëgjatësinë dhe kategorizimin e asetëve;
- ZRRE me datë 05 prill 2018 ka publikuar Përgjigje ndaj komenteve, të paraqitura nga palët e interesit, në lidhje me Kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësinë e asetëve;
- Kategoritë dhe jetëgjatësia e asetëve janë bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së arsyeshme teknike për secilin lloj të asetit, duke qenë se këto janë pjesë e një sistemi të përbashkët dhe nuk janë specifike për përdorues;
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të raportit konsultativ për kategoritë e asetëve dhe jetëgjatësinë e asetëve, si dhe analizimit të komenteve të paraqitura nga palët e interesit, dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar ato, dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

<sup>1</sup> TMRR dhe TMT janë transformatorët mates të rrymës dhe tensionit



- IV. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- VI. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes obligohen për zbatimin e këtij vendimi për periudhën e dytë rregullative 2018-2022.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhet e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Kompanisë Kosovare për Shpërndarje dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A (KEDS)
- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe
- Arkivit të ZRRE-së